

VENDIM
Nr. 161, datë 17.6.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “VOKOPOLA ENERGJI” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et:
“VOKOPOLA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 kw; “VOKOPOLA 2”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 3104 kw; DHE “VOKOPOLA 3”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2297 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 kw**

(ndryshuar me vendimin nr. 311, datë 30.11.2022, nr. 112, datë 27.3.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 925/4 prot., datë 16.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instaluar 274 kw; ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw; dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 20.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Pas kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/15 prot., datë 22.4.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.5.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Me shkresën nr. 471/1 prot., datë 27.4.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Në ERE u protokollua shkresa me nr. 471/2 prot., datë 3.6.2022, “Kthim përgjigje”, me anë të së cilës shoqëria ka depozituar dokumentacionin, në lidhje me aplikimin e saj.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 142, datë 6.6.2022, vendosi të shtyjë me 20 (njëzet) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare për kërkesën e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “d”;

- dokumentacioni teknik për HEC – neni 9, pika 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”.

- Leje nga institucione të tjera – neni 9, pika 4.1.5, germat “a” dhe “c”.

Në këtë aplikim konstatohet mungesë e dokumentacionit, si vijon:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2:

- germa “d”, shoqëria duhet të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

- germa “e”, shoqëria duhet të depozitojë në ERE licencën për drejtuesin elektrik për dy HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s;

- germa “g”, shoqëria duhet të përcjellë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë e zonës ku shtrihen HEC-et “Vokopola 1” dhe “Vokopola 2”, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3:

- germa “c”, shoqëria duhet të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve dokumentacionin, që vërteton aftësinë ose mbështetjen financiare për ndërtimin e dy veprave të tjera hidroenergjetike “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.

Leje nga institucione të tjera – neni 9, pika 4.1.5:

- germa “b”, shoqëria duhet të përcjellë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor për HEC “Vokopola 1”, përpara fillimit të operimit të tij.

Po ashtu, duke qenë se vërehet një gabim material në vendimin nr. 02/2020 dhe vendimin nr. 03/2020, të Këshillit të Basenit Ujor (KBU) Seman nëpërmjet të cilëve janë dhënë respektivisht lejet për HEC “Vokopola 2” dhe HEC “Vokopola 3”, vlerësohet që të komunikohet në mënyrë shkresore me shoqërinë për t’i përcjellë këto leje të saktësuara në ERE.

- Kontrata e Koncesionit e formës BOT, nr. 7 rep., nr. 3 kol., datë 10.1.2013, për ndërtimin e hidrocentraleve “Vokopola 1” dhe “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”, të ndryshuar, ka një afat 35-vjeçar, por shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit të sipërcituar, rezulton se periudha e mbetur për licencim është 25 vjet e 8 muaj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kw; “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kw; dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw, për një afat 25 vjet e 8 muaj.

2. Shoqëria “Vokopola Energy” sh.p.k., të paragesë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, jo më vonë se data 21.12.2023 (me Bashkinë Skrapar dhe Memaliaj) dhe jo më vonë se data 31.10.2024 (me Bashkinë Poliçan), ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

3. Shfuqizuar.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti